



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

VENDIM

Nr. 44 Datë 29.03 .2019

“ PËR
MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E
ZHURMAVE ”

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 26, pika "2"; ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, në nenin 38, i ndryshuar; udhëzim nr.6527 datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre”, i ndryshuar; ligjin nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar; udhëzim nr.8 datë 27.11.2007, “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i ndryshuar; v.k.m.-në nr.587, datë 07.07.2010, “Mbi monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane e turistike”; Plani Kombetar i Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave në Mjedis 2010, miratuar me VKM nr. 123, datë 17.02.2011; me propozim të kryetarit të bashkisë,këshilli bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e planit vendor të veprimit të zhurmave të Bashkisë Lezhë për periudhën 2019-2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI
Kristian GJIDODAJ

